



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:137192
Datë: 27.07.2024
Numri i dokumentit: 05989583

P. nr.482/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit A.J nga fshati T, komuna Pejë, për shkak të veprës penale „ Ngacmim seksual” nga neni 183 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Pejë, PP/II..nr.892/2023 dt.16.06.2023, mbajti seancen e shqyrtimit gjyqësor të mbyllur për publikun, me dt.27.02.2024 dhe dt.04.06.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit – Ermal Demhasaj, të pandehurit A.B, mbrojtësit të pandehurit av.Blerim Ademaj i caktuar sipas detyrës zyrtare, përf. të ZMNV-së, Zumreta Bašić dhe të dëmtuarës C.K, me dt. 06.06.2024, mori dhe shpalli publikisht, ndersa me datë 18.07.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

A.J i lindur me datë në G....., me banim në Pejë, Rr.,,.....” nr..., i biri i U dhe nënës Sh, e vajzërisë B, i pa ,punëtor krahu i, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal të lëshuar nga MPB-Prishtinë, posedon tel me nr.....i gjendjes së dobët ekonomike, egjiptian, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Konform nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKTAKUZA

Gjëja se:

Me dt....., rreth orës, në fshatin T K.Pejë,me dashje ngacmon seksualisht personin tjetër dhe atëtë tij, të dëmtuarën C.K me të cilat veprime cenon dinjitetin e saj dhe krijon mjedis i cili është objektivisht frikësues degradues e poshtëruës e poshtëruës, në atë mënyrë që pasi e dëmtuara ditën kritike kishte mbete vetëm në shtëpi me djalin e saj 1 muajsh, i pandehuri pasi që vëren se bashkëshortja e tij dhe djali kishin dal nga shtëpia i njëjti hyn në dhomën e të dëmtuarës e kap për dore, e puth pa dëshirën e saj dhe e prek në pjesët intime të

trupit ku më pas e dëmtuara duke bërtit e duke e shtyrë arrin ta largoj nga dhoma të njëjtin, ku pasi që bashkëshorti i saj dhe vjehrra kthehen në shtëpi, e njëjta tregon për rastin, e më pas e lajmëron edhe stacionin policor,

- me çka kishte për te kryer veprë penale “Ngacmim seksual” nga neni 183 par.1 të KPRK-së.
- për shkak se nuk u provua se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datë 16.06.2023, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II..nr.892/2003, kundër të pandehurit A.J nga Peja , për shkak të veprës penale “Ngacmim seksual” nga neni 183 par.1 të KPRK-së, duke propozuar që të mbahet seanca e shqyrtimit gjyqësor ndaj të pandehurit të lartcekur, të administrohen të gjitha provat dhe në fund të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit si dhe të detyrohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor jo publik me dt. 27.02.2024 dhe 04.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit A.J, mbrojtësit të pandehurit av. Blerim Ademaj i caktuar sipas detyrës zyrtare, mbrojtëses së viktimave nga ZMNV- së nga Peja Zumreta Bašić dhe të dëmtuarës C.K. Gjykata, të pandehurit ia ka caktuar mbrojtësin sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në nenin 57 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.2 të KPPRK-së, meqenëse i njëjti është i paarsimuar dhe nuk e kupton procedurën që zhvillohet ndaj tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP.II.nr.892/2023 të dt.16.06.2023, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri nuk e ka pruar fajësin për veprën penale për të cilën akuzohet, ashtu që gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave. Fillimisht palet në procedurë e kanë dhenë fjalën hyrëse, pastaj është dëgjuar e dëmtuara në cilësi të dëshmitarës C.K, është dëgjuar dëshmitari E.J, janë administruar provat e propozuara nga Prokuroria, ku me këtë rast janë lexuar, deklarata e të dëmtuarës C.K e dhënë në St. Policor në Pejë me dt 15.05.2023, deklarata e të pandehurit A.J e dhënë me dt 15.05.2023 në St. Policor në Pejë, deklarata e dëshmitarit E.J e dhënë me dt 16.05.2023 në St. Policor në Pejë, Raporti njoftues i policit Xhevdet Shala #8556 i datës 16.05.2023, si dhe mbrojtja e tij e dhënë në gjykatë .

Gjykata duke u bazuar në nenin 124 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me par. 3 të KPPK – së, dëshmitaren H.B e cila është dëgjuar në cilësinë e dëshmitares pasi e njëjta është deklaruar shprehimisht në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.06.2024, se nuk dëshiron të

deklarohet kundër të pandehurit, Bashkëshortit të saj, gjykata përmes aktvendimit procedural në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të lartcekur, e ka liruar nga detyrimi për të dëshmuar me arsyetimin se e njëjta është dëshmitare e liruar nga detyrimi për të dëshmuar meqenëse të pandehurin e ka bashkëshort.

Meqenëse dëshmitarja e lartcekur në shqyrtimin gjyqësor është liruar nga detyrimi për të dëshmuar siç u elaborua në pjesën e më lartë të këtij arsyetimi të aktgjykimit, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 335 par. 2 të KPPK – së në të cilën parashihet se, *“Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit nuk lexohen nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme”*, ka nxjerr aktvendim procedural në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, duke mos e lexuar deklaratën e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me datë 16.05.2023 nga dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar H.B, për faktin se po të lexoheshin dhe administrohen si prova, të njëjtat do të ishin prova të papranueshme ashtu siç parashihet në dispozitën ligjore të nenit 335 par. 2 të KPPK – së.

E dëmtuara, C.K, në cilesi të dëshmitarës, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e martuar në Pejë, me E qe 2 vite. Të pandehurin e ka Kur janë martuar kanë jetuar me burrin, kunatin, vjehrrin dhe vjehrrën. Me datë, rreth orës 9 ka qenë në shtëpi, vetëm me djalin dhe vjehrrin, ndërsa vjehrra ka shkuar tek vajza e saj, të cilën e ka dërgu burri i të dëmtuarës Edisoni. Ka qenë në dhomë me djalin 2 muajsh duke e veshur, ka hyrë në dhomë vjehrrin, e ka pyetur se ku është vjehrra e saj. E dëmtuara iu ka përgjigjur „, ti e din, ka shku të kunata”. Vjehrrin është kthyer në dhomën e vet, por prap ka hyrë në dhomën të e dëmtuarës edhe ka dashtë me kap, me puth, por e dëmtuara e ka shtyer. Vjehrrin, këtu i pandehuri, ka shkuar në dhomën e vet duke sharrë dhe duke e ofenduar të dëmtuarën. E dëmtuara ka bërë titur, ka thënë „,ik” , e ka mbyllur derën me çelës edhe ka prit deri sa ka ardhur burri i saj. Pasi qe e dëmtuara e ka mbyll derën, vjehrrin i saj nuk ka tentuar të hyjë në dhomë. Kur ka ardhur burri i të dëmtuarës, ka trokitur në derën e dhomës së të dëmtuarës dhe e ka pyetur „,çka ki?”. E dëmtuara ia ka thënë se s'ka send, mirëpo pasi e ka pyetur përsëri, e dëmtuara i ka treguar se baba i tij ka dashtë me kap, se i ka hyrë në dhomë. Pasi i ka treguar burrit, burri i saj, nuk ka bërë asgjë. Nuk e ka pyetur babën e vet se çka ka bo, por ka shkuar te nëna e tij, e cila ishte të vajza e saj, motra e E dhe i ka treguar asaj, ndërsa e dëmtuara ka qëndruar vetëm në dhomë me derë të mbyllur sepse nuk ka mundur të shkoj me E pasi ka qenë duke ra shiu, e burri E ka shkuar me motor. Pas ditës kritike janë larguar menjëherë të nesërmen nga ajo shtëpi e dëmtuara me burrin dhe me vjehrrën dhe djalin, janë dal nga shtëpia me arsyetimin se e kanë thirr për kartelën e ndihmës sociale, sepse përndryshe vjehrrin nuk do bti kishte lënë të dalin. Ka shtuar se i kujtohet deklarata e dhënë në polici me dt.15.05.2023, mirëpo nuk i kujtohet çdo detaj sepse ka qenë e shqetësuar dhe ka harruar. Tani nuk jetojnë së bashku me të pandehurin, e dëmtuara jeton me burrin, djalin dhe vjehrrën në shtëpi me qira, ndërsa i pandehuri jeton vetëm. Para ditës kritike i pandehuri ka pasur sjellje të mirë me të dëmtuarën dhe nuk ka qenë i dhunshëm, ndërsa ditën kritike i pandehuri-vjehrrin i saj, ka dashtë me e puth i është afruar të fytyra të dëmtuarës, por e dëmtuara e ka larguar. Qëllimi i të pandehurit ka qenë veç me e puth se iu kishte afruar afër, ndërsa e dëmtuara i kishte

qit duart para fytyrës. Në pyetjen e mbrojtësit se “Këtu në seancë keni deklaruar se i pandehuri ka tentuar me të puth, ndërsa në polici ke deklaruar se më ka puth, më ka prek në pjesët intime. Cila është e vërteta?” E dëmtuara është përgjigjur “Jo nuk me ka puth e as nuk me prek në pjesët intime”. E dëmtuara po ashtu ka deklaruar se i pandehuri e ka kap për dore dhe ja ka bo dorën zi. Nuk i kujtohet se sa dite pas ngjarjes e ka lajmëruar rastin ne polici.

Dëshmitari, Edison Jasharaj në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se jeton me nënën, gruan, djalin, 2 vëllezër dhe motrën. Të pandehurin e ka baba dhe nuk jeton së bashku me të. Dëshmitari po ashtu, ka shtuar se me dt.11.05.2024, ka qenë duke ngrënë buke, baba e ka rreh dhe i ka thënë dil prej shtëpisë. Dëshmitari është nis tek nëna e tij dhe kanë shkuar në polici. Dëshmitari ka deklaruar se në ora 7 të mëngjesit ka del nga shtëpia, kur e ka kryer punën është kthyer në shtëpi me ç ‘rast i kishte treguar gruaja se e ka nguc baba i tij, vjehri saj, ka dashtë me puth me zor, dëshmitari nuk ka bërë zë veç ka shkuar drejtë tek nëna e tij dhe nëna i ka thënë “shko në shtëpi, mos bo zhurmë”. Ndërsa, me babën nuk ka fol dhe nuk ka diskutuar hiç për ngjarjen që i ka treguar nusja e tij, sepse nuk jetojnë me babën mbasi ia kishte ngacmuar gruan. Dëshmitari ka deklaruar se, ai vet nuk e ka parë me sy, vetëm sipas asaj që i ka treguar nusja e tij, që e ka kap për krahu dhe ka dashtë me puth, mirëpo e njëjta e ka fsheh fytyrën me dorë dhe e ka pengu. Lidhur me shenjen e zezë në krahu, bashkëshorten kanë dashtë me dërgu polica të mjeku, por bashkëshortja nuk ka shkua.

I pandehuri A.J, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ndër të tjera në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me dt.11.05.2023, është qu djali me shku në punë, rreth orës 7-7:30, nuk e din çka kishin pas mes veti nusja me djalin, i pandehuri i ka thënë nuses se mos ti bërtet nipit, përveç asaj fjale nuk i kam thënë asgjë tjetër. Nuk është e vërtetë që e ka ngacmuar nusen e djalit, ndërsa qëllim pse e kanë lajmëruar është sepse gruaja e të pandehurit nuk dëshiron të jetoj me të, por dëshiron të ndahet. Ka shtuar se C.K është bashkëshortja e djalit të tij, me të njëjtën kanë jetuar në bashkësi familjare deri në momentin kur e kanë paraqit në polici. Arsyesimi i familjareve se ata nuk po jetojnë me të, është për shkak të rastit, por ajo nuk është e vërtetë. Me dt.11.05.2023 i ka thënë nuses se djalit që mos të përlehet me djalë. Pas kësaj, E ka ardh në shtëpi, nuk e din a ka biseduar me C, ka hyrë ne dhomën e vet, ku ka qenë edhe C, E pasi ka biseduar me C është larguar nga shtëpia. Po ashtu, i pandehuri ka shtuar se, në polici ka kërkuar që e dëmtuara të kontrollohet nëse ka shenja, sepse nuk është e vërtetë se e ka ngacmuar dhe e gjitha kjo është shpikje nga bashkëshortja e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se, pas përfundimit të shqyrtimit dhe administrimit të provave u vërtetua në tersi gjendja faktike e përshkruar si ne dispozitivin e aktakuzës, pra u vërtetu se i pandehuri me dt.11.05.2023 rreth orës 09:00, ne fsh.T, komuna Pejë, me dashje ngacmon seksualisht personin tjetër dhe atë nusen e djalit te tij, Cima Kadrijaj, e me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.1 i KPRK-se. Se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale kjo me se miri u dëshmuar nga dëshmia e viktimës C K gjate shqyrtimit gjyqësor, e cila dëshmi është ne përputhje me deklaratën e saj te dhënë në Stacion Policor, e po ashtu edhe me dëshminë e dhënë nga dëshmitari bashkëshorti i saj E J, i cili dëshmoj se ne çfarë gjendje emocionale e ka gjet bashkëshorten e tij ditën kritike. Mbrojtja e te pandehurit është ne kundërthënie me qëllim të shmang përgjegjësinë penale nga vepra e kryer, kjo u vërtetu me dëshminë e dhënë nga i njëjti gjatë shqyrtimit, ku i pandehuri tani ndryshe

nga deklarata e dhënë ne polici, pretendon se i është drejtuar viktimës ne mënyrë përkëdhelëse dhe as ne një forme tjetër. Në prezencën e këtyre rrethanave ka kërkuar që gjykata të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale e cila i bie në barrë dhe t'i shqiptoj dënim siç parashihet me ligj. Ndërsa me rastin e matjes së dënimit, gjykata të merr parasysh faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare si dhe dënimet penale të mëparshme të pandehurit, rrethana lehtësues te mos merr asnjë.

Mbrojtësja e viktimave në fjalën përfundimtare deklaroi se ngacmimi seksual si vepër penale ka ndikuar negativisht në aspektin psikik, emocional dhe fizik tek e dëmtuara, përkrah provat të cilat janë te cekura në aktakuzë dhe kërkon kompensim dëmi.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit, heq dorë nga kërkesa pasurore juridike dhe kërkon që i pandehuri të mos e shqetësoj.

Mbrojtësi i te pandehurit ne fjalën përfundimtare deklaroi, se gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se i mbrojturi i tij, nuk është kryes i veprës penale ngacmim seksual, nga neni 183 par.1, pasi qe me dëgjimin e të dëmtuarës u vërtetua ne tërësi se i mbrojturi i tij nuk e ka ngacmuar, pasi qe sipas aktakuzës, të dt.16.06.2023, ne dispozitivin e saj thuhet: "i pandehuri e kap për dore, e puth pa dëshirën e saj dhe e prek ne pjesët intime te trupit, ku me pas e dëmtuara duke bërtitur dhe duke e shtyrë arrin ta largoj nga dhoma te njëjtin". Këto pretendime nuk u vërtetuan pasi qe edhe vet e dëmtuara ne seancën e shqyrtimit gjyqësor, nder të tjera ka deklaruar se, ka dashtë me më puth, ne pyetje e parashtruar nga mbrojtja se a te ka puthur i pandehuri apo te ka prek, e njëjta është përgjigjur jo. Po ashtu dëshmitari E ne seancën gjyqësore dëshminë e mbështet ne thëniet se çka i ka thënë e dëmtuara. Ndërsa me dëgjimin e A.J i cili ka qene shume korrekt dhe i sinqertë ne dhënien e deklaratës se tij në polici por edhe në gjykate, e dëshmon se ndaj te dëmtuarës nuk ka marr asnjë veprim ngacmues. Ndërsa sa i përket pretendimeve të dëmtuarës dhe dëshmitarit se i pandehuri kinse i ka shkaktuar lëndime ne dorën e majte nuk mbështet ne asnjë prove, as në raport mjekësore apo me fotografi. I ka propozuar gjykatës qe ne mungese të provave të pandehurin ta liroj nga aktakuza.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se, e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij.

Me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata gjeti se nuk është provuar se i pandehuri A.J, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri „Ngacmim Seksual” nga neni 183 par.1 të KPRK-së përkufizohet si: “ Kushdo që ngacmon seksualisht personin tjetër, në veçanti personin i cili është i ndjeshëm për shkak të moshës, sëmundjes, paaftësisë, varësisë, shtatzënisë, paaftësisë së rëndë fizike apo mendore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet”, ku në thelbin e saj për t’u ndërtuar figura e kësaj vepre penale duhet të ekzistojnë fjalët apo ndërmarrja e veprimeve për qëllime seksuale ndaj subjektit pasiv, ashtu që në rastin konkret nuk ka prova që vërteton faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet, për çka Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta liroj nga akuza.

Gjykata gjeti se në rastin konkret prova kundër të pandehurit, Abaz Jashari, lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet, kemi vetëm deklaratën e të dëmtuarës C.K, si dhe deklaratën e dëshmitarit E.J, i cili ndër të tjera gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se “ai vetë nuk e ka pare me sy, vetëm sipas asaj qe i ka treguar nusja e tij”, e që në fakt provë kundër te pandehurit Abaz i bie të jetë vetëm deklaratata e të dëmtuarës.

Sa i përket raportit njoftues të zyrtarit policor Xhevdet Shala edhe pse i njëjti është administruar si provë gjykata nuk ia fali besimin meqenëse i njëjti nuk është prove me të cilën vërtetohet gjendja faktike, por me të njëjtin vërtetohet paraqitja e rastit nga këtu e dëmtuara dhe veprimet konkrete të policisë ditën kritike lidhur me këtë rast penal.

Provë kundër të pandehurit lidhur me figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri ishte vetëm deklaratata e të dëmtuarës e dhënë ne Polici me dt. 15.05.2023, ku e dëmtuara kishte deklaruar se “Pastaj ka ardhur në dhomën ku kam qenë unë dhe me ka kapur për dore me forcë dhe me ka puthur dhe me ka prekur për pjesët intime te trupit” ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor e dëmtuara deklaroi se “jo nuk me ka puth e as nuk me prek ne pjesët intime”. E dëmtuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nder të tjera deklaroi se ka “dasht mem kap, mem puth por unë e kom shty edhe o dal ne sob te vet”, andaj duke u mbështetur në faktin se vet e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se “jo nuk me ka puth e as nuk me prek ne pjesët intime” gjykata vlerësoi se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet e të përshkruar si ne dispozitiv të aktakuzës, pasi që nuk kishte asnjë prove që vërtetonte se i pandehuri ditën kritike e ka kapur për dore më forcë dhe e ka puthur dhe prekur për pjesët intime te trupit te dëmtuarën. E po ashtu i pandehuri e ka mohuar veprën penale, duke deklaruar se nuk është e vërtetë qe e ka ngacmuar nusen e djalit.

Ndërsa, lidhur me deklarimin e të dëmtuarës të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ku deklaroi se, i pandehuri e ka kap për dore dhe ja ka bo dorën zi, ka dashtë me e puth dhe i është afrua te fytyra, gjykata nuk ja fali besimin deklaratës së të dëmtuarës pasi qe deklaratata e të dëmtuarës nuk mbështetet ne asnjë provë tjetër materiale, përkatësisht nuk kishte asnjë raport mjekësor që vërtetonte lëndimin e të dëmtares.

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit E.J, mirëpo gjykata nuk ja fali besimin duke pas parasysh faktin se dëshmitari nuk ishte dëshmitarë okular, përkatësisht nuk kishte parë veprimet për të cilat akuzohet i pandehuri, por dëshmitari deklaroi se, ai vet nuk e ka parë me sy, vetëm sipas asaj qe i ka treguar nusja e tij.

Meqenëse në shkresat e lëndës nuk kemi ndonjë provë tjetër qe mbështet deklaratën e të dëmtuarës, por kemi vetëm deklaratën e të dëmtuarës e cila thotë se i pandehuri e ka kap për dore dhe ja ka bo dorën zi, ka dashtë me e puth dhe i është afrua te fytyra, por e dëmtuara e ka largu, ndërsa, nga ana tjetër i pandehuri deklaroi se nuk është e vërtetë qe e ka ngacmuar nusen e djalit, në prezencën e këtyre rrethanave gjykata nuk e shpalli të pandehurin fajtor duke u mbështetur vetëm në deklaratën e të dëmtuarës, e për me tepër ne deklaratat e të dëmtuarës ka ndryshim të deklaratës se dhënë në Polici, me deklaratën e dhënë ne shqyrtimin gjyqësor, në pjesën kur e dëmtuara përshkruan veprimet e të pandehurit që ndërliidhen me figurën e veprës penale, pasi qe e dëmtuara ne Polici kishte deklaruar se “Pastaj ka ardhur ne dhomën ku kam

qenë unë dhe me ka kapur për dore me forcë dhe me ka puthur dhe me ka prekur për pjesët intime të trupit” ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor e dëmtuara deklaroi se “ jo nuk me ka puth e as nuk me prek ne pjesët intime”. Andaj meqenëse në këtë rast kemi vetëm deklaratën e të dëmtuarës kundër deklaratës se të pandehurit, ku deklarata e të dëmtuarës nuk ishte e qëndrueshme, gjykata duke pas parasysh edhe parimin “in dubio pro reo”, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen i interpretoi në favor të pandehurit.

Gjykata ia fali besimin deklaratës se të pandehurit kur i njëjta deklaroi se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi qe gjykata nuk kishte asnjë provë tjetër që do të vërtetonte të kundërtën e asaj çka deklaroi i pandehuri.

Gjykata thekson se prokuroria nuk ka bërë përpjekje siç e obligon neni 7 të KPPRK-së, në rastin konkret, Prokuroria ka dështuar në detyrën e saj, të ashtuquajturën “barrën e provës” (onus probandi), që të mbledhë prova të mjaftueshme dhe bindëse se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, përderisa, gjykata ka obligim ligjor që të vërtetoje gjendjen faktike mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor. Në lidhje me këtë Gjykata, rikujton një ndër parimet kryesore të procedurës penale “In dubio pro reo”, të përcaktuar në nenin 3 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i cili përcakton se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij”, ndërsa interpretimi tjetër në lidhje me këtë parim është së “në dëm të pandehurit mund të merret një fakt vetëm atëherë ai kur është vërtetuar pa mëdyshje, kur ekzistimi i tij qëndroj jashtë çdo dyshimi”.

Po ashtu, në këtë drejtim mund të konkludohet së ky parim është një rregull e përgjithshme dhe e pavarur e procedurës penale. Parimi se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, aplikohet në procedurën penale me rastin e zgjidhjes së të gjitha fakteve kontestuese, si të atyre që e rëndojnë të pandehurin, ashtu edhe të atyre që i shkojnë në favor. Prandaj, nga kjo del rregulla se të gjitha faktet që shkojnë në dëm të pandehurit, duhet të vërtetohen patjetër me bindje të plotë, por nëse nuk mund të vërtetohen kësisoj, sepse edhe më tutje mbetet dyshimi për ekzistimin e tyre, merret se ato nuk ekzistojnë. Përkundrazi, për të gjitha faktet që shkojnë në favor të të pandehurit, po qe se paraqiten si të mundshme, e ajo mundësi nuk ka mundur të zëvendësohet me bindje të plotë, duhet të merret patjetër se ekzistojnë. Andaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të të njëjtave, e në bazë të elaborimeve të lartcekura, gjykata ka ardhur në konstatim së nuk është vërtetuar se i pandehuri është kryer i veprës penale „Ngacmim seksual” nga neni 183 par.1 të KPRK-së.

Ashtu siç është potencuar më sipër, gjykata aktgjykimin e vet, e mbështet vetëm në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Andaj, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar, kjo Gjykatë nuk mundi të vërtetoj përtej dyshimit mirë të bazuar se këtu i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilat akuzohet. Pretendimet e Prokurorisë nuk u provuan me asnjë prove të vetme, andaj gjykata të njëjtit

konform nenit 363 par 1. nën par. 1.3, të KPPRK-së¹, e në mungesë të provave, e ka liruar nga akuza dhe për të njëjtin ka marrë aktgjykim lirues.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Konform nenit 462 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e dëmtuara udhëzohet në kontest juridiko civil.

Andaj, nga të cekurat si më lartë e konform nenit 363 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.482/2023, me datë 18.07.2024.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtare e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

¹ *Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse: nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet*